# A K T I   T H E M E L U E S

## I SHOQERISE PRIVATE TREGETARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

## (SH.P.K.) LUCI GEKAS

Neni 1

Me baze te ligjit 7638 dt. 19.11.1992 "Per Shoqerit Tregetare" ne te quajturit:

1- Luci Cela i biri i Shefitit dhe i Fahries i dt. 1957, lindur e banues ne Tirane dhe

2- Kostandinos Gekas i biri i Joanit dhe i Mantha i dt. 1946, lindur e banues ne Janine te Greqise.

Me zotesi te plote juridike per te vepruar, shpallim formimin e shoqerise private tregetare te perbashket me pergjegjesi te kufizuar (SH.P.K) te quajtur "LUCI CELA GEKAS"

Neni 2

Shoqeria si person juridik zhvillon veprimtarine e saj ne te gjithe teritorin e Republikes Se Shqiperise, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi, statutin dhe kete akt themelimi.

## O B J E K T I   I   S H O Q E R I S E

Neni 3

Objekti i shoqerise eshte:

- Tregetim, import-eksport i mallrave te ndryshme industriale, elektroshtepiake, elektroteknike, materiale ndertimi, pjese kembimi per automjete hidrosanitare, me shumice e pakice brenda e jashte Shqiperise,

## KAPITALI I SHOQERISE

Neni 4

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 lek ne para i depozituar ne Banken e Shtetit Shqiptar.

Ky kapital eshte vene nga dy ortaket themelues ne pjese te barabarta:

1- Luci Cela 50.000 lek

2- Kostandinos Gekas 50.000 lek.

Kapitali i shoqerise mund te shtohet ose te paksohet ne te gjitha menyrat e lejuara nga ligji.

## SELIA E SHOQERISE

Neni 5

Selia e shoqerise eshte ne kete adrese:

Luci Cela lagje "Apollonia" Bashkia Fier.

Shoqeria mund te hap edhe vendqendrime te tjera operative dhe filiale ne teritorin e Republikes se Shqiperise,

NOTER FIER

AFATI I VEPRIMTARISE

Neni 6

Shoqeria do te zhvilloje veprimtarine e saj tregetare mbji dhjete vje te njepasnjeshme e larte.

Aktiviteti i saj mund te zgjas me shume se dhjete vjete, por edhe mun te nderpritet ne cdo kohe me vendim te ortakeve themelues, sipas rasteve te parashikuara ne statut,

Neni 7

Shoqeria mban pergjegjesi per te gjitha detyrimet fiskale dhe sigurimet shoqerore per personat e punesuar.

Neni 8

Fitimi i realizuar nga veprimtaria e shoqerise do te ndahet midis ortakeve, ne perputhje me kapitalin e vene nga secili ortak.

Neni 9

Shoqeria fiton zotesine per te vepruar me regjistrimin e saj ne regjistrin tregetar ne Gjykaten E Rrethit Tirane,

Neni 10

Shoqeria fillon aktivitetin e saj tregetar, ne momentin e rregjistrimit ne organin kopetent shtetror per marjen e licences ne degen e tatimeve.

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I SHOQERISE

Neni 11

Menyra dhe drejtimi i shoqerise jane te percaktuara ne statutin e shoqerise.

Administrator i shoqerise caktohet z. Minella Muci.

Neni 12

Mardheniet e punes ne shoqeri rregullohen ne baze te legjislacionit te punes, me kontrata individuale dhe kolektive te punes midis shoqerise dhe te punemarseve.

Neni 13

Shoqeria ka vulen e saj ne te cilen shkruhet:
"SH.P.K. LUCI GEKAS" Fier.

VLEFSHMERIA E AKTIT THEMELUES

Neni 15

Ky akt themelues eshte lidhur per nje periudhe jo me pak se dhjete vjete, por ky afat mund te ndryshoje sipas vendimit qe do te marin ortaket themelues ne mbledhjen e asamblese.

ZGJIDHJA E MOSMARVESHJEVE

Neni 15

Te gjitha mosmarveshjet qe mund te lindin ne veprimtarine e shoqerise do te zgjidhen nga Gjykata, ne rast se ato nuk do te zgjidhen me mirkuptim e konsensus.

Neni 16

Ceshtjet qe nuk jane regulluar ne kete akt themelimi rregullohen ne statutin e shoqerise si pjese perberese e saj.

Neni 17

Ne qofte se shoqeria do te pushoje veprimtarine e saj, atehere do te caktohet nje komisjon likujdimi i cili do te paraqes bilancin e likujdimit ne mbledhjen e asamblese.

Neni 18

Ky akt themelimi hyne ne fuqi daten e nxjerjes dhe te nenshkrimit nga ortaket themelues te shoqerise.

ORTAKET THEMELUES

(Luci Cela) (Kostandinos Gekas)

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA FIER
Nr. 480 Rregj.

Fier, me 26/01/ 2000

VERTETIM

Vertetohet se sot me dt. 26/01/ 2000, para meje Noterit Minella Milo u paraqiten z. Luci Cela dhe Kostandinos Gekas, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar te identifikuar sipas ligjit dhe nenshkruar aktin e themelimit te mesiperm ne prezencen time.

NOTERI
(Minella Milo)

Perkthyesi
(Lluka Zani)

## STATUT

## I SHOQERISE TREGETARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

## "SH.P.K. LUCI GEKAS"

Me mbeshtetje te ligjit 7638 dt. 19.11.1992 ;"Per Shoqerit Tregetare" ne te quajturit:

1- Luci Cela i biri i Shefitit dhe i Fahries i dt. 1957, lindur e banues ne Tirane dhe

2- Kostandinos Gekas i biri i Joanis dhe i Mantha i dt. 1946, lindur e banues ne Janine te Greqise.

Me zotesi te plote juridike per te vepruar, shpallim formimin e shoqer private tregetare me pergjegjesi te kufizuar (SH.P.K) te quajtur"LUCI GEKAS" me statutin si me poshte:

### FORMIMI I SHOQERISE TREGETARE "LUCI GEKAS"

Neni 1

Formohet shoqeria tregetare private e quajtur "LUCI GEKAS", nga Ortaket e siperpermendur, qe perballojne humbjet deri ne kufirin e kapitalit themeltar.

### OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE

Neni 2

Shoqeria ka si objekt te veprimtarise se saj:
Tregeti, Import-Eksport i mallrave te ndryshme industriale, elektroshtepiake, elektroteknike, materiale ndertimi, pjese kembimi per automjete, hidrosanitare me shumice e pakice brenda e jashte Shqiperise.

### KOHE ZGJATJA E SHOQERISE

Neni 3

Shoqeria do te zhvilloje veprimtarine e saj mbi dhjete vjete te njepasnjeshme e larte.

Aktiviteti i saj mund te zgjas me shume se dhjete vjete, por edhe mund te nderpritet ne cdo kohe me vendim te asamblese se ortakeve sipas rasteve te percaktuar ne statut.

Neni 4

### KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 lek ne para i depozituar ne Banken e Shtetit Shqiptar.

Ky kapital eshte vene nga dy ortaket themelues ne pjese te barabarta:

1- Luci Cela 50.000 lek

2- Kostandinos Gekas 50,000 lek.

NOTER FIER

Neni 5

Kapitali i shoqerise mund te shtohet ose te paksohet ne te gjitha menyrat e lejuara nga ligja ne baze te vendimit qe do te marin ortaket n mbledhjen e asamblese.

Neni 6

Pjeset e kapitalit the meltar jane lirishte te transferushme ndermjete ortakeve, gjithashtu pjeset e kapitalit themeltar mund te trasferohen edhe te treteve personave ose shoqerive me miratim te ortakeve.

Gjithashtu ato jane lirishte te trasferushme ne raste ndarje pasurore mes bashkeshorteve si dhe ne rruge trashegimie.

Transferimet e pjeseve te kapitalit themeltar duhet te vertetohet me nje akt noterial-,

Neni 7

Fitimi i realizuar nga veprimtaria e shoqerise do te ndahet midise ortakeve, ne perputhje me kapitalin e vene ne shoqeri nga cdo ortak.

Neni 8

SELIA E SHOQERISE

Selia e shoqerise do te jete ne kete adrese:

Luci Cela lagje "Apollonia" Bashkia Fier

Shoqeria mund te hap edhe vendeqendrime te tjera te dyta, operative dhe filjale ne te gjithe teritorin e Republikes se Shqiperise.

Neni 9

Shoqeria mund te ndryshoje emertimin e saj, seline si dhe objekti e saj sipas vendimit qe do te marin ortaket ne mbledhjen e asamblese,

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I SHOQERISE

Neni 10

Shoqeria drejtohet dhe administrohet nga nje ose me shume drejtues (Administrator), persona fizik, pjesmares ose jo ne shoqeri, me ose pa kufizim mandati te tyre te zgjedhur nga ortaket.

Administratori ka keto kopetenca:

- Emron dhe revokon punonjes ne shoqeri ne baze te kontratave te punes, percakton trajtimin e tyre, pagat dhe shperblimet.
- Ka te drejte te marre hua dhe kredi bankare.
- Kryen te gjitha veprimet per blerjen dhe shitjen e mallrave.
- Ka te drejte qe te perfaqesoje vet ose te autorizoje persona te tjere ose avokate per te perfaqesuar shoqerine ne organet gjyqesore dhe shtetrore per problemet e shoqerise.

Administrator i kesaj shoqerie caktohet z. Minella Muci. Ai kopetencat e mesiperme si administrator do ti kryej ne baze te autorizimit qe do ti leshohet nga ortaket themelues te shoqerise.

Neni 11

NOTER FIER

Organi me i larte i shoqerise eshte Asamblea e Ortakeve dhe ka keto kopetenca:

- Vendos per ndryshimin e emertimit te selise dhe objektit te veprimtarisse se shoqerise.
- Vendos per emrimin dhe shkarkimin e administratoreve te shoqerise-
- Vendos per ndarjen dhe perdorimin e fitimit dhe per mbulimin e humbjeve te shoqerise.
- Vendos per ndryshimin e formave te organizimit te shoqerise,
- Vendos per mbylljen dhe pushimin e shoqerise.
- Vendos per nxjerjen e rregullores se shoqerise (per mbledhjen e asamble
- Aprovon bilancin dhe investimet e shoqerise.
- Vendos per te gjitha ceshtjet e rendesishme ne drejtimin dhe funksionimin e shoqerise.

Neni 12

Vendimet e mbledhjes se asamblese merren me pelqimin e te pakten 3/4 te pjesmarseve ne kapitalin e shoqerise.

BILANCI DHE TE ARDHURAT

Neni 13

Shoqeria nderton veprimtarine ekonomiko-financiare mbi bazen e leverdise ne kushtet e ekonomise se tregut te lire, mbeshtetur, ne mundesit e kreditimit dhe huazimit nga shteti apo persona te tjere fizik e juridik vendas e te huaj, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi, ne mundesit e zhvillimit te investimeve te saj.

Veprimtaria ekonomike kryhet ne vazhdimesi dhe gjen pasqyrimin e saj ne bilancin periodik.

Neni 14

Shoqeria ka llogarine e saj rrjedhese ne Banken e Shtetit Shqiptar dhe mund te hap edhe ne vende te tjera nepermjet te cilave kryen veprimet e saj bankare.

Neni 15

Ne bilancin periodik pasurit e saj jane te shprehura ne monedhe shqiptare dhe sipas rastit edhe ne monedhe te huaj ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

Ne baze te ketij legjislacioni shoqeria percakton edhe format e bilanceve e te llogarive per dokumentimin e veprimtarise ekonomiko-financiare.

Neni 16

Bilanci mbyllet me 31 dhjetor te cdo viti.

Llogarit vjetore, inventari, raportet mbi operacionet e vitit financiar

dhe raportet e hartuara nga ekspert kontabel i autorizuar nga ortaket themelues, miratohen ne mbledhjen e asamblese. Miratimi i ketyre dokumentave mbi veprimtarine vjetore behet brenda nje afati kater muajsh nga data e mbylljes se vitit financiar.

NOTER FIER

Neni 17

Pas miratimit te llogarive vjetore dhe evidentimit te ekzistences se fitimeve, percaktohet pjesa qe u takon ortakeve ne formen e devidentit m fitimin.

Ky fitim perbehet nga fitimi i vitit financiar, te cilit jane zbritur shuma e lene per fondin rezerve te domozdoshem te percaktuar nga ortaket, te fondeve te tjera qe shihen te nevojeshme dhe nga ana tjeter ja zbritur ose jane shtuar respektivishte humbjet apo fitimet e miratuara nga vitet e mepereshme.

Neni 18

Shoqeria kur e shikon te perligjur mund te investoje ne ndermarje, shoqeri e persona te tjere fizik e juridik, vendas e te huaj kapitalet e saj.

Neni 19

Shoqeria ka vulen e saj ne te cilen shkruhet "SH.P.K. LUCI GEKAS" Fier.

Neni 20

Mardheniet e punes ne shoqeri rregullohen ne baze te legjislacionit te punes, Kodit te Punes, aktin e themelimit dhe kete statut.

Neni 21

Shoqeria sipas nevojave qe paraqiten puneson specialiste e puntor duke lidhur kontrata individuale e kolektive te punes per punesimin e tyre.

Neni 22

Ne shoqeri munde te aderojne edhe persona te tjere ne kushtet e caktuara ne mbledhjen e asamblese me vota unanime.

Neni 23

Personat aderues kane po ato te drejta dhe detyrime qe kane edhe ortaket themelues, me perjashtim te atyre kufizimeve qe jane vendosur me rastin e aderimit te tyre,

Neni 24

Me rastin e largimit nga shoqeria te personave aderues, ata mbartin me vehte pjesen e fitimit qe u takon deri ne momentin e largimit te tyre, dhe detyrimet qe ka shoqeria po per kete periudhe.

Neni 25

Shoqeria organizon kontroll te brendeshm me ekspert kontabel te autorizuar.

Neni 26

Konsiderohen si sekrete te punes te gjitha aktet dhe dokumentat qe jane vendosur ne mbledhjen e asamblese.

Neni 27

Shoqeria deklarohet e krijuar daten e regjistrimit ne regjistrin Tregetar prane Gjykates Krethit Tirane.

Neni 28

Shoqeria fillon aktivitetin e saj ekonomik me regjistrimin ne organin perkates tatimor (Dega Fier).

SHPERNDARJA DHE LIKUJDIMI I SHOQERISE

Neni 29

Shoqeria pushon veprimtarine ne keto raste:

- Ne rastet e parashikuara ne ligj.
- Ne rast ndarje, bashkimi apo pamundesie per te vazhduar veprimtarine.
- Me urdher te organit kopetent shtetror si rrjedhoje e shkeljes se ligji
- Kur perfundon qellimin per te cilin eshte krijuar.
- Ne keto raste krijohet komisjoni i likujdimit i cili paraqet raportin perkates ne mbledhjen e asamblese.

Ajo kryen te gjitha veprimet e nevojeshme per cregjistrimin e shoqerise ne Gjykaten e Rrethit Tirane (Regjistrin Tregetar).

Neni 30

Ky statut hyn ne fuqi daten e nenshkrimit nga ortaket themelues te shoqerise.

O R T A K E T   T H E M E L U E S

(Luci Cela)   (Kostandinos Gekas)

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA FIER
Nr, 481 Rregj.

Fier, me 26/01 2000

V E R T E T I M

Vertetohet se sot me dt. 26/01 2000, para meje Noterit Minella Milo u paraqiten z. Luci Cela dhe Kostandinos Gekas, me zotesi te plote juridike per te vepruar te identifikuar sipas ligjit dhe nenshkruan statutin e mesiperm ne prezencen time,.

Perkthyesi
Lluka Zani

N O T E R I
(Minella Milo)

REPUBLIKA E SHQIPERISE MINELLA MILO NOTER FIER